

AKTIVITETET E AGJENCISË SHTETËRORE TË ARKIVAVE TË KOSOVËS

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës gjatë vitit 2019, me qëllim të përmbushjes së objektivave, detyrave, dhe veprimtarisë së vet, duke qenë në përputhje me planin e punës, me raste të caktuara edhe jashtë tij, ka realizuar një sërë aktivitetesh të cilat do t'i paraqesim në vijim.

Në fushën e bashkëpunimit janë zhvilluar këto aktivitete:

Pjesëmarrje në promovimin e revistës “Arkivat Shqiptare”, Tiranë-Shqipëri

Delegacioni i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i ASHAK-së z. Ramë Manaj dhe z. Hamit Shala, Drejtor i DAF, më 17.11.2018 morën pjesë në Promovimin e Revistës “Arkivat Shqiptare”, që është botim i përbashkët i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë. Promovimi i Revistës u mbajt në Pallatin e Kongreseve, Salla Ovale në Tiranë. Promovimi i Revistës u bë me rastin e Panairit të 21 të Librit.

Në panel ishin z. Ramë Manaj, Kryeshef Ekzekutiv i ASHAK-së dhe z. Ardit Bido, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, z. Hamit Shala, Drejtor i DAF-it, i ngarkuari me punë në Ambasadën e Kosovës në Shqipëri z. Sylë Ukshini, dhe znj. Pranvera Dibra Drejtoreshë e Arkivit të Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, arkivistë dhe studiues të fushave të ndryshme.

Në këtë promovim ishte pjesëmarrje mjaftë e madhe e elitës intelektuale shqiptare duke filluar nga akademik, profesorë, shkencëtar etj.

Pjesëmarrje në Simpoziumin “Të drejtat e refugjatëve në dokumente”, Zagreb -Kroaci

Më datë 15.11.2018, delegacioni i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës i përbërë nga z. Ramë Manaj, Kryeshef Ekzekutiv i ASHAK dhe z. Hamit Shala, Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Financave, ishin pjesëmarrës në

Simpoziumin Ndërkombëtar për “Të drejtat e refugjatëve në dokumente”, i cili i zhvilloi punimet në Kampusin Borongaj të Universitetit të Zagrebit. Simpoziumi u organizua nga Instituti i Kërkimeve të Studimeve Kroate në Universitetin e Zagrebit dhe ICARUS-HR në bashkëpunim me Projektin për Refugjatë dhe të Drejtat e Njeriut, nga Qendra e Informacionit në Departamentin e Studimeve Informativë të Universitetit të Los Anxhelosit dhe Universitetin e Liverpoolit. Tema bosht e Simpoziumit ishte të drejtat e refugjatëve në dokumente, sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen. Në këtë simpozium me kumtesë u paraqit edhe Kryeshefi i ASHAK, z. Ramë Manaj, i cili paraqiti gjendjen aktuale të refugjatëve bazuar në legjislacionin vendor.

Pjesëmarrje në Akademinë përkujtimore “Malli për Rugovën” në Suedi
Më datë 18-20.01.2019, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, z. Ramë Manaj, me ftesë të Shoqatës së shkrimtarëve dhe krijuesve shqiptarë “Papa Klementi i XI Albani” në Angelholm të Suedisë, mori pjesë në akademinë përkujtimore të titulluar “Malli për Rugovën”, kushtuar figurës së Presidentit historik Dr. Ibrahim Rugova, si dhe manifestimin “Dita e Plisit”.

E gjithë kjo u organizua nga Shoqata e shkrimtarëve dhe krijuesve shqiptarë “Papa Klementi i XI Albani” në Suedi në bashkëpunim me Lidhjen Demokratike të Kosovës - Dega Suedi, dhe Shoqatën Kulturore “Nënë Tereza” në Angelholm të Suedisë.

Gjatë këtij evenimenti, përveç fjalimit përshëndetës të kryetarit të SHKSH “Nënë Tereza” dhe drejtuesve znj. Saranda Iseni dhe z. Osman Ahmetgjekaj, për Presidentin Rugova folën edhe z. Ramë Manaj, Kryeshef Ekzekutiv i ASHAK, znj. Qibrije Hoxha, Kryetare e Degës së LDK-së në Suedi dhe z. Hysen Ibrahimimi. Organizatorët e këtij manifestimi e prezantuan z. Ramë Manaj si një veprimtar të devotshëm të LDK-së dhe bashkëpunëtor të ngushtë të të ndjerit Ibrahim Rugova.

Në këtë event u përruan edhe disa libra të krijuesve shqiptarë si dhe dy leksikone të rëndësishme për mërgatën shqiptare që jeton e punon në Suedi. Në fund u mbajt edhe një orë letrare, ku poezitë e lexuara kryesisht iu kushtuan Dr. Ibrahim Rugovës, plisit dhe mikut më të madh të shqiptarëve Ulmar Qvick.

Pjesëmarrje në Konferencën V Ditët e ICARUS-it në Kroaci dhe Konventën e 23 të ICARUS-it, Pulla, Kroaci

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, z. Ramë Manaj dhe z. Valdrin Shehu, Drejtor i ANK-Gjakovë, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Arkivat e Kroacisë, nga data 27-29 mars 2019 morën pjesë në Konferencën e 5^{të} Ditët e ICARUS-it në Kroaci dhe Konventën e 23^{të} të

ICARUS-it me temën bosht “Arkivat Interaktive - Sfidat Digjitale dhe Rrjetet Bashkëpunuese”. Konferenca u mbaj në Pulla të Kroacisë.

Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare në Radenci të Sllovenisë

Konferenca vjetore “Problemet teknike në fushën e arkivimit tradicional dhe elektronik”, e cila organizohet çdo vit në Radenci të Sllovenisë, edhe këtë vit u mbajt nga data 3-5 prill 2019 me temën bosht “Të dhënat sensitive dhe personale tek krijuesit dhe në arkiva”. Pjesëmarrës nga ASHAK-u ishin Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, z. Ramë Manaj, z. Ruzhdi Panxha, Drejtor i DVA, dhe z. Bekim Aliu, Zyrtar për digjitalizim, i cili edhe u paraqit me temën “Digjitalizimi si mundësi për ruajtje të fondeve në rrezik- Rasti në Kosovë”.

Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare E-Arkiviminë Lubjanë – Slloveni

Delegacioni nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i ASHAK z. Ramë Manaj, me ftesë të Arkivave të Sllovenisë, më datën 7.05.2019, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “E-Arkivimi”, e cila trajtoi problemet e E-Arkivimit të dokumenteve me të cilat ballafaqohen arkivistët në punën e tyre të përditshme, duke u munduar që bashkërisht të gjejnë zgjidhje adekuate për të gjithë.

Bashkë organizim dhe pjesëmarrja në Konferencën “Arkivat dhe të drejtat e njeriut”, në Shkup, Maqedoni e Veriut

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në bashkëpunim me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (Maqedoni e Veriut) dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë më 14 – 15 qershor 2019, organizuan në Shkup të Maqedonisë së Veriut Konferencën e III Ndërkombëtare të Arkivistikës “Arkivat dhe të drejtat e njeriut”. Konferenca zhvilloi pesë sesioni ku u paraqitën gjithsejtë 26 Kumtesa nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Nga Kosova u prezantuan kumtesat si ë vijim:

- Ramë MANAJ- Kryeshef Ekzekutiv i ASHAK-së u paraqit me një fjalë rasti për Organizimin dhe rëndësinë e Konferencës;
- Pranvera GASHI – “Arkivat elektronike – arkiva të kohës moderne”;
- Adem ADEMI – “Shkelja e të drejtave njerëzore në Kosovë 1990 – 1997, sipas materialeve të Arkivit të Kosovës”;
- Hysen AZEMI - ASHAK, “Historiku i zhvillimit të arkivave në Kosovë

- nën regjimet represive”;
- Dr. Jusuf OSMANI - “Gjetja, komunikimi dhe ruajtja e informatave në institucionet arkivore”;
 - MA. Sami SALLAHU – “Arkivi Qendror i Policisë së Kosovës-Administrimi dhe ruajtja e informacionit të klasifikuar”;
 - Zeliqe SHALA, ASHAK – “Shërbimi dhe përgjegjësitë institucionale ndaj dokumenteve;
 - Demokrat VATAJ – “Shfrytëzimi i lëndës arkivore”;
 - Hysen IBRAHIMI – “Arkivi shqiptar nga Suedia”;
 - M.A. Shpresa MEKAJ, ASHAK – “Bashkëpunimi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës me Arkivat në Rajon”;
 - M.A. Fikrie BERISHA, ASHAK – “Pasqyrë historike e themelimit dhe zhvillimit të arkivave në Kosovë”;
 - M.A. Ruzhdi PANXHA, ASHAK – “Burime arkivore për themelimin dhe rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881”;
 - M.A. Hamit SHALA, ASHAK – “Arkivat, mjedisi natyror dhe katastrofat mjedisore”;
 - Ma. Izet ABDYLI, Biblioteka Kombëtare e Kosovës – “Koleksionet latine në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës”;
 - Dr. Hatixhe AHMEDI, ASHAK – “Vlera artistike e dokumenteve në gjuhën osmane në Arkivin e Kosovës me vështrim të veçantë një berât i vitit 1315/1898”;

Dorëzimi i dokumenteve të rëndësishme për Kosovën në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës

Me qëllim të pasurimit të arkivit më datën 23.11.2018, Prof. Dr. Eqrem Zenelaj i dorëzoi Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dokumente historike me rëndësi kombëtare, si Skema e Mbretërisë Ilire nga Bardhyli, Skema e familjes Balshaj, etj., harta të trojeve shqiptare dhe fotografi të personaliteteve politike-fetare e kombëtare shqiptare, të cilat janë hulumtuar në arkivat dhe bibliotekat evropiane. Kryeshefiekzekutiv i ASHAK-së z. Ramë Manaj falënderoi Prof. Dr. Eqrem Zenelaj për këtë kontribut, si dhe shtoi se këto dokumente do ta pasurojnë Arkivin dhe konsiderohen një thesar me vlerë të madhe për historinë e Kosovës dhe ASHAK-në.

Marrja e dokumentacionit të Komitetit “Shqipëria e Lirë” në New York të SHBA-së

Delegacioni i ASHAK, i përbërë nga z. Ramë Manaj, Kryeshef Ekzekutiv, z.

Hamit Shala, Drejtor i Departamentit dhe znj. Shpresa Mekaj, Drejtoreshë e Departamentit, më datën 19.05.2019 udhëtuan për New York, me qëllim të marrjes së dokumentacionit të veprimtarisë së Komitetit “Shqipëria e Lirë” dhe sjelljes së tij në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për ruajtje të përhershme. Komiteti në fjalë, gjatë veprimtarisë së vet, ndër të tjerat si detyrë ka pasur edhe sensibilizimin e opinionit amerikan për gjendjen e shqiptarëve në Kosovë, andaj edhe është cilësuar si dokumentacion me vlerë të madhe dhe sjellja e tij në Arkivin e Kosovës është e një rëndësie të veçantë për qytetarët e Kosovës dhe mbarë kombin shqiptar. Delegacioni gjatë periudhës së qëndrimit në New York (19.05.2019 - 29.05.2019) ka digjitalizuar rreth 6000 dokumente të Komitetit “Shqipëria e Lirë”, të cilat në formën digjitale janë sjell në Kosovë.

Edhe këtë vit, sikurse viteve tjera, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në kuadër të aktiviteteve të saj hapi dy Ekspozita.

Më 16.02.2019 u hap ekspozita “Qytetet shqiptare në fotografitë e vjetra, 1863-1916”

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, nën Patronatin e Zyrës së Kryeministrit dhe në bashkëpunim me Prof. Dr. Eqrem Zenelaj, për nder të 11 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më datën 17.02.2019, çelën në Muzeun Kombëtar të Kosovës Ekspozitën “Qytetet shqiptare nëfotografitë e vjetra,1863-1916”.

Ekspozita “Figurat Kombëtare Shqiptare dhe Familjet Aristokrate në veprat e artistëve evropianë”

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në bashkëpunim me Prof. Dr. Eqrem Zenelaj, për nder të 2 korrikut (Deklaratës Kushtetuese të vitit 1990) si dhe me rastin e pensionimit të Kryeshefit Ekzekutiv të ASHAK, z. Ramë Manaj, më 2 korrik 2019, hapën në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë ekspozitën “Figurat Kombëtare Shqiptare dhe Familjet Aristokrate në veprat e artistëve evropianë”. Në hapje të ekspozitës ishte i pranishëm edhe Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, z. Ardit Bido me bashkëpunëtorë, si dhe shumë figura të jetës kulturore e politike të Kosovës.

Java e Arkivit të Hapur

Me rastin e kremtimit të 69 vjetorit të themelimit të Arkivit të Kosovës, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës nga data 25-29 mars 2019 organizoi JAVËN E

ARKIVIT TË HAPUR.

Gjatë Javës së Arkivit të Hapur, ASHAK hapi dyert për publikun me ç'rast të interesuarit patën mundësinë që të shohin për së afërmi punën e përditshme dhe aktivitetet e ndryshme që bëhen në ambientet e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. E gjithë kjo u bë me qëllim të informimit të publikut të gjerë me rëndësinë të cilën e kanë arkivat e një shteti. Vendet të cilat patën mundësinë të vizitojnë të interesuarit ishin:

- Salla e leximit, aplikimi dhe shërbimi në sallën e leximit;
- Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore;
- Laboratori i Restaurimit dhe Konservimit;
- Laboratori i Mikrofilmimit dhe Digjitalizimit;
- Depo e ASHAK-së;
- Biblioteka.

Ky aktivitet u përcoll me interesim të madh dhe iu siguria hapësirë në programet e mediave të ndryshme, të cilat i falënderojmë për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre. Gjatë kësaj jave, ASHAK-në e vizituan rreth 2000 vizitorë të profileve të ndryshme. Vizitorët ishin nga institucionet vendore dhe institucionet arsimore të niveleve të ndryshme, si dhe qytetarë të tjerë të interesuar.

Hulumtime

Hulumtimet në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut

Prej 16.07.2019 deri më 19.07.2019, delegacioni i përbërë nga z. Ramë Manaj, Kryeshf Ekzekutiv i ASHAK, dhe z. Ruzhdi Panxha, Drejtor i DVA, realizuan hulumtime në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut, nga ku janë sjell dokumentet në formë digjitale, të cilat kanë të bëjnë për Kosovën.

Botime

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në kuadër të veprimtarisë botuese këtë vit ka botuar:

- Punimet “Master” të Arkivistëve të ASHAK-së;
- Hysen Azemi: *Fazli Grajqevci dhe vrasësit e tij*

Përgatiti: Habibe QOVANAJ